

LIGJ

Nr. 25/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9355, DATË 10.3.2005 “PËR
NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të
Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

Në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen
këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi “Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të
Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse për
zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike, pagesën për personat me aftësi të kufizuara”.

Neni 2

Në nenin 26, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministri përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore ngre strukturën
përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me
aftësi të kufizuara, e cila kontrollon veprimtarinë dhe zbatimin e legjislacionit në strukturat dhe
institucionet në varësi të tij dhe seksionet e ndihmës ekonomike në bashki ose komuna, si dhe
miraton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 27 pika 5 shkronja “c” të këtij ligji.”.

Neni 3

Në nenin 27, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve shoqërore
bëhet nga inspektorati që mbulon këtë fushë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë
16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

7. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave,
në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në
krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7984, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani